



Datë: 08.07.2025
Numër Protokolli: 4579/2025

A.nr.1082/2025

Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës-Kolegji për Shqyrtimin dhe Vendosjen e Ankesave në përbërje nga: Ardita Haxhnikaj Demi, kryetare, Malsore Gashi-Bajraktari dhe Eshref Shabani, anëtarë, me Avdyl Bekteshi, në cilësinë e procesmbajtësit, në procedurë sipas ankesës me numër A.nr.1082/2025, të datës 05.06.2025, të parashtruar nga ankuesi F.S, kundër organit të punësimit/Komunës së Istogut, në çështjen juridike “*kërkesë nga marrëdhënia e punës*”, duke vepruar në pajtim me nenin 6 paragrafin 1 nën paragrafin 1.1, nenin 16 paragrafi 3, dhe nenin 18 paragrafin 1 nën paragrafin 1.5 të Ligjit Nr.06/L-048 për Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, si dhe Rregulloren Nr.02/2018 për Procedurën e Shqyrtimit dhe Vendosjes së Ankesave në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, në seancën për këshillim dhe votim të mbajtur më datën 08.07.2025, mori këtë:

V E N D I M

Përfundon procedimi administrativ i filluar sipas ankesës me numër A.nr.1082/2025, të datës 05.06.2025, të parashtruar nga ankuesi F.S.

A r s y e t i m

Ankuesi F.S (*në tekstin e mëtejme referuar* Ankuesi), më datë 05.06.2025, ka parashtruar ankesë në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, kundër mos kthimit në vendin e punës, ndërsa, ankuesi më datë 02.07.2025 përmes parashtrësës ka bërë tërheqjen e ankesës me numër protokolli 3797/2025 të datës 05.06.2025, me arsyetimin se me datën 02.07.2025, kam pranuar vendimin nga komuna e Istogut për kthim në vendin e pezulluar të punës.

Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës bazuar në dispozitat e Rregullores Nr.02/2018 për Procedurën e Shqyrtimit dhe Vendosjes së Ankesave, me datë 12.06.2025, ka proceduar kërkesën për përgjigje në ankesë në Komunën e Istogut, ndërsa, kjo e fundit, më datë 24.06.2025 dhe 25.06.2025, ka përcjell dokumentacionin lidhur me çështjen në procedurë.

Kolegji i Këshillit, nga shqyrtimit i provave të lëndës, ka konstatuar se janë plotësuar kushtet ligjore për përfundimin e procedimit administrativ lidhur me ankesën e ankuesit, *sepse*:

Andaj, Kolegji i Këshillit pas pranimit të kërkesës së ankuesit për tërheqje nga ankesa, e duke u bazuar në nenin 103 paragrafin 1 të Ligjit Nr.05/L-031 për Procedurën e Përgjithshme Administrative, me të cilin është përcaktuar se: *1. Një procedurë administrative e nisur sipas kërkesës, përfundon nëse pala që e ka bërë kërkesën e tërheq atë*”, vendosi që të përfundoj procedurën administrative të iniciuar sipas ankesës me numër A.nr.1082/2025, të datës 05.06.2025.

Theksuar si me sipër, e në mbështetje të nenit 18, paragrafi 1 nën paragrafi 1.5 të Ligjit Nr.06/L-048 për Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, u vendos si në dispozitiv të këtij vendimi.

Këshillë juridike: *Vendimi hyn në fuqi në ditën e nënshkrimit nga Kryetarja e Kolegjit. Kundër vendimit të Këshillit, pala e pakënaqur e cila pretendon se vendimi i Këshillit nuk është i ligjshëm mund të iniciojë konflikt administrativ në Gjykatën Themelore në Prishtinë–Departamenti për Çështje Administrative, brenda afatit prej tridhjetë (30) ditësh nga dita në të cilën i është dorëzuar vendimi. Inicimi i konfliktit administrativ nuk e ndalin ekzekutimin e këtij vendimi.*

KËSHILLI I PAVARUR MBIKËQYRËS PËR SHËRBIMIN CIVIL TË KOSOVËS
Lënda me numër A.nr.1082/2025

Avdyl BEKTESHI

Procesmbajtës

Ardita Haxhnikaj DEMI

Kryetare e Kolegjit

Vendimi i dërgohet:

- Ankuesit F.S;
- Udhëheqësit të Burimeve Njerëzore në Komunën e Istogut; dhe
- Arkivit të KPMSHCK-së.